




# ANALIZA E ECURISË SË ÇMIMIT TË SHUMICËS DHE PAKICËS TË MANDARINES NË VEND DHE RAJON, PERIUDHA 5 TETOR – 5 DHJETOR



Burimi Prishtinës: [www.food-ks.org](http://www.food-ks.org) Rijekë: <http://www.tisup.mps.hr> Beograd: [www.stips.minpolj.sr.gov.yu](http://www.stips.minpolj.sr.gov.yu)




Burimi Prishtinës: [www.food-ks.org](http://www.food-ks.org) Rijekë: <http://www.tisup.mps.hr> Beograd: [www.stips.minpolj.sr.gov.yu](http://www.stips.minpolj.sr.gov.yu)



Burimi 2008: [www.mbumk.gov.al](http://www.mbumk.gov.al)


Ecuria e çmimit të mandarinës në tregjet e Tiranës, Fierit, Prishtinës, Rijekës dhe Beogradit, është paraqitur në grafikun I. Çmimi mesatar i mandarinës vendase në tregun e Tiranës dhe Fierit për periudhën dy mujore është luhatur pothuajse rreth të njëjtës mesatare, 81.6 lek/kg dhe 82.2 lek/kg, respektivisht. Mandarina është shfaqur në të dyja tregjet gjatë javës së dytë të Tetorit. Ashtu sikurse duket dhe nga grafiku, çmimi fillestar në fillim të sezonit ka pësuar ulje në të dyja tregjet, ulje e cila ka vazhduar deri në fund të javës së parë të Nentorit. Mbas kësaj date çmimi ka qëndruar pothuajse stabil në Tiranë por është ulur më tej në tregun e shumicës të Fierit. Në Tiranë çmimi është ulur 40 përqind gjatë 3 javëve të para të fillimit të sezonit, kurse në Fier 30 përqind. Përtej kësaj date çmimi i mandarinës vendase në Fier është ulur edhe 30 përqind. Më në detaj, çmimi i mandarinës gjatë javës së tretë të Tetorit në Tiranë është luhatur rreth vlerës 117 lek/kg, për të vijuar në 99 lek/kg dhe 86 lek/kg në javët pasardhëse të Tetorit, dhe rreth vlerave 77 lek/kg, 71 lek/kg, 68 lek/kg dhe 67 lek/kg në Nëntor. Në tregun e Fierit çmimi është luhatur rreth ketyre vlerave në Tetor: 126 lek/kg, 105 lek/kg, 82 lek/kg, kurse në Nëntor 76 lek/kg, 66 lek/kg, 61 lek/kg dhe 54 lek/kg. Çmimi mesatar i mandarinës në tregun e Prishtinës për periudhën 2 mujore rezultojnë 125 lek/kg, ndërkohë që mandarina është shitur mesatarisht 55 % më shtrenjtë se në Fier. Çmimi Beograd është luhatur rreth vlerës 115 lek/kg dhe mandarina është shitur mesatarisht 61 % më shtrenjtë se në Fier. Diferenca me çmimin e shumicës në Rijeka rezultojnë vetëm 27%. Grafiku II tregon çmimin maksimal FOB (free on board) Fier që mund të negociohet nëse malli shitet në Beograd dhe Prishtinë. Për shkak të çmimit mjaft konkurrues të mandarinës në Rijeka eksporti i produktit në këtë destinacion rezultonte pa avantazh konkurrues në çmim. Çmimi maksimal FOB është llogaritur duke hequr nga çmimi i shumicës kostot e transportit, zhdoganimit dhe tarifave të importit (tarifa e importit në Kosovë për mandarinën është 0% kurse në Serbi 5%). Sikurse duket edhe nga grafiku avantazhi konkurrues në tregun e Prishtinës është modest. Hapësira negociuese përgjatë gjithë periudhës është vetëm 48% mbi çmimin e shumicës. Megjithatë fitimi më i lartë rezultojnë gjatë periudhës 23 Tetor-10 Nëntor kur diferenca e çmimit maksimal FOB Fier me atë të tregut të shumicës është 80%. Hapësira negociuese është mesatarisht më e ulët (21%) në Beograd për shkak të çmimit të ulët të këtij produkti në fillim të periudhës atje, sikurse dhe për shkak të kostove më të larta të transportit dhe zhdoganimit. Hapësira negociuese rritet pas datës 16 Nëntor me rritjen e çmimit të shumicës atje, duke sinjalizuar edhe njëherë rëndësinë e momentit të hyrjes në treg. Grafiku III tregon ecurinë e çmimit të shumicës së mandarinës të vendit dhe importit të periudhës Janar – Nentor të vitit 2008 dhe periudhës Tetor, Nentor 2009. Vihet re prezenca me konsistente e mandarinës të importit edhe jashtë sezonit. Diferenca në çmimin mesatar midis shumicës të importit dhe vendit kur ato janë të dyja të pranishme rezultojnë vetëm 8%. Diferenca midis çmimit të mandarinës të vendit dhe të importit gjatë 2 muajve të observuar të vitit 2009 është thelluar në 31%. Kjo ka ardhur si rezultat i një çmimi më konkurrues të mandarinës vendase ndërkohë që çmimi i mandarinës të importit nuk ka shumë ndryshim nga vjet. Ndërkohë një vështrim në fluksin e importeve mujore gjatë vitit tregon se ato ndjekin kryesisht kërkesën konsumatore për këtë produkt me një cikël që fillon në Shtator e mbaron në Mars. Me rritjen e ofertës së këtij produkti në treg çmimi i tij tenton të ulet dhe e kundërta ndodh në fund të sezonit.

Grafiku IV: Konsumi vjetor vendas i mandarines 2004-2007, mln lek




Burimi: ACIT, AAC, \* prodhim vendas eshte estimuar nga te dhena sekondare

Grafiku V: Çmimet e pakicës gjatë periudhës 5 Tetor-5 Dhjetor në Tiranë dhe në vendet e rajonit në lek/kg



Burim Prishtinës: [www.food-ks.org](http://www.food-ks.org) Rijekë: <http://www.tisup.mps.hr> Beograd:: [www.stips.minpolj.sr.gov.yu](http://www.stips.minpolj.sr.gov.yu)

Grafiku VI: Çmimi i pakicës së mandarines të vendit dhe importit për periudhën 5 Tetor-5 Dhjetor 2009, si dhe për të njëjtën periudhë në 2008-n, në lek/kg



Burimi 2008: [www.mbumk.gov.al](http://www.mbumk.gov.al)

Nga pikpamja e kërkesës konsumatore mund të themi se mandarina vendase ka rritur prezencën dhe peshën e saj duke fitur gjithnjë e më shumë terren ndaj ofertës së importuar. Ashtu sikurse duket edhe ne grafikun 4, gjate viteve 2000-2003 kërkesa konsumatore mulohej vetëm nga mandarina e importit, ndërsa duke filluar nga viti 2004 e më tej rëndësia e prodhimit vendas është rritur. Kështu në vitin 2004 prodhimi vendas përbën vetëm 13 % të mandarines të ofruar në treg ndërkohë që 87 % mbulohej nga mandarina e importit. Gjatë këtyre viteve të fundit prodhimi vendas është shumëfishuar (nga 760 ton ne vitin 2004 ne rreth 2600 ton ne vitin 2008) , gjë që ka bërë që ai të mbulojë rreth 37 përqind të kërkesës konsumatore.

Grafiku V tregon ecurinë e çmimeve të pakicës të mandarines së vendit dhe importit në tregun e pakicës të Tiranës si dhe në disa qytete ne rajon. Sikurse duket edhe nga grafiku diferenca midis çmimit të mandarines së vendit dhe importit është shumë e vogël, vetëm 3 përqind, gjë që na tregon se gjatë kësaj periudhe shitja e mandarines vendase është më e volitshme për shkak të marzhit më të lartë të fitimit (duke e krahasuar me grafikun e mësipërm, ku çmimi mesatar i mandarines vendase është rreth 30 % me i lire se ai i importit). Sigurisht që këtu duhen pasur parasysh edhe diferencat e lokaliteteve brenda vendit. Kështu diferenca më e lartë midis çmimit të shumicës dhe pakicës të mandarines të vendit rezulton në Fier (91%), ndjekur nga (Lushnja 32 %) dhe Korçe e Tirane (rreth 15%). Marzhi i fitimit ose diferenca mesatare midis çmimit të pakicës dhe shumicës për mandarinën e importit, për këtë periudhë, në tregjet e observuara, varion brenda segmentit 18 -22%. Ndërkohe diferenca në çmimin e pakicës të mandarines vendase dhe asaj të importit është e lartë në Lushnje (pra mandarina e vendit shitet më lirë aty), gjatë kësaj periudhe 35% kurse ne tregjet te tjera varion brenda mesatares 0 – 10% për të gjithë periudhën. Në krahasim me tregjet e pakicës të rajonit çmimet rezultojnë më të ulta sikurse duket edhe nga grafiku 5. Gjithsesi përshtypje të bën çmimi konkures në tregun e pakicës të Rijeka, gjë që tregon edhe njëherë karakterin prodhues të Kroacisë (në lidhje me këtë produkt). Grafiku VI merr në vëzhgim çmimet e pakices të mandarines gjatë kësaj periudhe në vitin 2008 dhe në vitin 2009. Këtu konfirmohet edhe njëherë syjerim i bërë më lart se ndryshe nga produkte të tjera vendase si molla, etj. çmimi i mandarines vendase është shumë i përafert me atë të të njëjtit produkt të importit. Kjo më shumë se për një produkt jo konkures në nivel çmimi (çmimi i shumicës i mandarines vendase rezulton gjithsesi me konkures) dëshmon për një produkt afër shijes konsumatore. Mandarina vendase përmbush gjithnjë e më shumë kërkesën kosumatore dhe ka shumë mundësi që ajo të zëvendësojë edhe më tej importin duke dalë më herët në Shtator, duke vonuar kështu prurjet e të njëjtit produkt të importit. Ruajtja e mirë mund ta zgjasë prezencën e saj përtej Marsit. Megjithatë në kontekstin e gjetjes së tregjeve të eksportit, hapsira negociuese ne dy vende të rajonit rezulton më e ulët se për produkte të tjera si molla, apo domatja për të cilat hapsira negociuese në sezon është shumë më e lartë (sipas analizave të mëparshme të kryera nga SITA). Me rritjen e shkallës të prodhimit dhe uljen e kostove për njësi, mund të rriten avantazhe konkures në çmim në të ardhmen. Momentalisht këto avantazhe, edhe për shkak të konkures kroate, me prodhimi komercial të mandarines, janë të ulta, për rajonin. Pra momentalisht fokusi parësor mbeten teknikat për efikasiteti dhe rritjen e prodhimit të mandarines në vend, duke pasur parasysh edhe shanset e mira natyrore. Në plan të dytë, teknikat e marketimit dhe pershtatja ndaj një kërkesë konsumatore më të sofistikuar. mund të hadin dritën ieshile dër eksdorte dërtei raionit. në nië të ardhme të afërt.